


tetor 2017

# gap | analizë

## Menaxhimi i buxhetit familjar: gratë dhe burrat



Ky hulumtim u mundësua nga Programi i Angazhimit për Barazi (E4E), i financuar nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar – USAID dhe implementuar nga Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim – ATRC. Përmbajtja është përgjegjësi e Institutit GAP dhe nuk pasqyron doemos pikëpamjet e Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar – USAID, Qeverisë së Shteteve të Bashkuara apo Qendrës së Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim – ATRC.



## Përmbledhje ekzekutive

Studime të ndryshme tregojnë se gratë kryefamiljare, për dallim nga burrat kryefamiljarë, shpenzojnë më shumë nga buxheti i tyre në zhvillimin e kapaciteteve njerëzore, sikurse në edukim dhe shëndetësi. Shpenzimet e burrave kryefamiljarë për konsum janë më të mëdha se sa ato të grave kryefamiljare, ku më të theksuara janë dallimet në shpenzimet për duhan, ushqim dhe pije.

Në Kosovë aktualisht janë mbi 26,000 mijë familje të cilat marrin ndihmë sociale, që përbëjnë afro 10% të të gjithë familjeve në Kosovë. Sipas skemës aktuale të ndihmës sociale, rreth 32% të bartësve të ndihmave sociale janë gra ndërsa 68% janë burra. Sa i përket shpërndarjes së bartësve nëpër kategori, vërehet një ndarje më e pa balancuar në kategorinë II të Skemës së Ndihmës Sociale (SNS), ku vetëm 8% të bartësve të ndihmave janë gra. Qëllimi i kësaj analize është që të testojë në mënyrë kuantitative dallimet në mes të grave dhe burrave kryefamiljarë në shpenzimin e buxhetit familjarë, pasi që gjetjet potenciale mund të shërbejnë për të propozuar buxhetim më optimal në aspektin e shpërndarjes së ndihmave sociale sipas gjinisë së kryefamiljarit/es.

Për të ardhur deri të këto rezultate, kemi konstruktuar tri modele që masin gjasat e kryefamiljarëve në Kosovë për të shpenzuar në shëndetësi, duhan dhe ushqime të shëndetshme. Konkretisht jemi bazuar në modelin Logit dhe kemi përdorur si burim të të dhënave Anketën e Buxhetit të Ekonomive Familjare (ABEF) 2016 të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK). Gjetjet e

modeleve tona tregojnë që krahasuar me gratë kryefamiljare, burrat kryefamiljarë në Kosovë kanë gjasë të shpenzojnë më pak në shëndetësi (6%) dhe ushqim të shëndetshëm (4.4%), e më shumë në duhan (7%).

Përveç analizimit të shpenzimeve të kryefamiljarëve në shëndetësi dhe duhan në mënyrë kuantitative, kjo analizë ofron disa rekomandime për politika më optimale në këtë fushë. Me qëllim të menaxhimit më të mirë të buxhetit familjar dhe fuqizimit të grave, Qeveria do të duhej që të rris shumën e asistencës sociale për familjet në asistencë sociale të cilat kryesohen nga gratë. Një shtytje e tillë, sado marginale, do të rriste numrin e grave si bartëse të ndihmave sociale marrë parasysh jetesën e këtyre familjeve në kushte të varfërisë së skajshme.

## Hyrje

Viteve të fundit, studiuesit kanë shprehur interesim më të madh rreth mënyrës së shpenzimit të buxhetit nga ekonomitë familjare, në veçanti rreth lidhshmërisë në mes të qenurit kryefamiljare grua që menaxhon buxhetin dhe mirëqenies së familjes.<sup>1</sup> Mënyra e shpenzimit të buxhetit nga gratë dhe burrat ndikohet në masë të madhe nga normat kulturore të një vendi dhe pozita e gruas në shoqëri. Shumë shpesh këta faktorë përcaktojnë qasjen e pabarabartë të këtyre grupeve në burime. Në shumicën e vendeve, qofshin ato të zhvilluara apo në zhvillim, ekziston një hendek në mes të ardhurave të burrave dhe grave, ku këto të fundit paguhen më pak.<sup>2</sup>

Studime të ndryshme shpërfaqin diskriminimin e grave në raport me burrat në kuadër të kushteve për punë, sikurse disponueshmëria e më pak inputeve për prodhim për gratë se sa për burrat.<sup>3</sup> Si rrjedhojë, krahasimi i mënyrave të shpenzimit të buxhetit nga këto dy kategori nuk është i lehtë, pasi që faktorët më lartë mund të përcaktojnë dallimet e orientimit të buxhetit familjar. Mirëpo, siç theksojnë disa autorë, këto masa jofavorizuese ndaj grave mund

---

<sup>1</sup> Shih studimin e DeGraff, D. S., & Bilsborrow, R. E. (1993). Female-headed households and family welfare in rural Ecuador. *Journal of Population Economics*, 6(4), 317-336. Si dhe shih studimin e Khan, A. H., & Khalid, U. (2012). Consumption patterns of male and female headed households in Pakistan: evidence from PSLM 2007-08. *The Pakistan Development Review*, 465-478.

<sup>2</sup> Arulampalam, W., Booth, A. L., & Bryan, M. L. (2007). Is there a glass ceiling over Europe? Exploring the gender pay gap across the wage distribution. *ILR Review*, 60(2), 163-186, shpërfaq hendekun në të ardhura në Europë, si dhe Blau, F. D., & Kahn, L. M. (2000). Gender differences in pay (No. w7732). *National bureau of economic research*.

<sup>3</sup> Banerjee, A. V., & Duflo, E. (2011). Poor economics: A radical rethinking of the way to fight global poverty. *Public Affairs*.

të kompensohen pjesërisht nga menaxhimi më i mirë i buxhetit nga gratë kryefamiljare.<sup>4</sup>

Përderisa gjetjet e studimeve rreth shpenzimit të buxhetit familjar nga burrat dhe gratë e pamartuara janë të ndryshme dhe të fokusuara në shumë aspekte<sup>5</sup>, ato mbi gratë dhe burrat kryefamiljarë janë më shumë të fokusuara në mirëqenien e familjes.

Gjetjet e Donkoh dhe Amikuzuno (2011) tregojnë se gratë kryefamiljare, për dallim nga burrat kryefamiljarë, shpenzojnë më shumë nga buxheti i tyre në zhvillimin e kapaciteteve njerëzore sikurse në edukim dhe shëndetësi.<sup>6</sup> Për më shumë, studime të ngjashme, theksojnë se shpenzimet e kryefamiljareve gra në edukim<sup>7</sup> dhe shëndetësi<sup>8</sup> janë më shumë të orientuara tek fëmijët. Mirëpo, të qenurit kryefamiljare grua e divorcuar ka efekt negativ më të potencuar në regjistrimin e fëmijëve në shkollë se sa të qenurit kryefamiljare grua e martuar ose e pamartuar. Ndërsa, shpenzimet e burrave kryefamiljarë për konsum janë më të mëdha se sa ato të grave kryefamiljare, ku më të theksuara janë dallimet në shpenzimet për duhan, ushqim dhe pije.<sup>9</sup>

Andaj, bazuar në strukturën e shpenzimeve në baza gjinore Oppong (1983), Bruce (1989) dhe Thomas (1990) vijnë në përfundim se resurset e

<sup>4</sup> DeGraff, D. S., & Bilsborrow, R. E. (1993). Female-headed households and family welfare in rural Ecuador. *Journal of Population Economics*, 6(4), 317-336, si dhe e Khan, A. H., & Khalid, U. (2012). Consumption patterns of male and female headed households in Pakistan: evidence from PSLM 2007-08. *The Pakistan Development Review*, 465-478.

<sup>5</sup> Për shembull, O'Guinn, T. C., & Faber, R. J. (1989). Compulsive buying: A phenomenological exploration. *Journal of consumer research*, 16(2), 147-157, vërejnë tendenca për blerje të pa planifikuara të gratë. Mirëpo, një studim i mëhershëm i Kollat, D. T., & Willett, R. P. (1967). Customer impulse purchasing behavior. *Journal of marketing research*, 21-31, dokumenton se nuk ka kallim mes dy gjinive në raport me blerjet e pa planifikuara.

<sup>6</sup> Donkoh, S. A., & Amikuzuno, J. A. (2011). The determinants of household education expenditure in Ghana. *Educational Research and Reviews*, 6(8), 570.

<sup>7</sup> DeGraff, D. S., & Bilsborrow, R. E. (1993). Female-headed households and family welfare in rural Ecuador. *Journal of Population Economics*, 6(4), 317-336.

<sup>8</sup> Duflo, E. (2003). Grandmothers and granddaughters: old - age pensions and intrahousehold allocation in South Africa. *The World Bank Economic Review*, 17(1), 1-25.

<sup>9</sup> Khan, A. H., & Khalid, U. (2012). Consumption patterns of male and female headed households in Pakistan: evidence from PSLM 2007-08. *The Pakistan Development Review*, 465-478. Si dhe Atkinson, A. B., Gomulka, J., & Stern, N. H. (1990). Spending on alcohol: evidence from the Family Expenditure Survey 1970-1983. *The Economic Journal*, 100(402), 808-827. Po ashtu, shih Palipudi, K. M., Gupta, P. C., Sinha, D. N., Andes, L. J., Asma, S., McAfee, T., & GATS Collaborative Group. (2012). Social determinants of health and tobacco use in thirteen low and middle income countries: evidence from Global Adult Tobacco Survey. *PLoS one*, 7(3), e33466.

menaxhuara nga gratë, sikurse të ardhurat, kanë më shumë gjasë të promovojnë mirëqenien e familjes se sa kur ato menaxhohen nga burrat. Pra, duke kontrolluar për nivelin e resurseve, gjejmë se gratë kryefamiljare rrisin mirëqenien e familjes, dhe të fëmijëve në veçanti, në krahasim me burrat kryefamiljarë.<sup>10</sup> Po ashtu, në nivelin rajonal, një analizë mbi menaxhimin e buxhetit nga gratë dhe burrat kryefamiljarë në Shqipëri gjen se gratë kryefamiljare menaxhojnë më mirë buxhetin familjar se sa burrat.<sup>11</sup>

Andaj, qëllimi i kësaj analize është që të testojë në mënyrë kuantitative dallimet në mes të grave dhe burrave kryefamiljarë në Kosovë në shpenzimin e buxhetit të familjes. Për shkak të nën-mostrës së vogël të grave dhe burrave kryefamiljarë bartës të ndihmës sociale, analiza është bërë duke përfshirë të gjithë kryefamiljarët pjesë e anketës (2,313 anketa). Mirëpo, në analizën tonë kemi kontrolluar edhe për të ardhurat e ekonomisë familjare dhe kjo përjashton ndikimin e qasjes së ndryshme në resurse të kryefamiljarëve në rezultatet e variablës së gjinisë.

Si rrjedhojë, gjetjet potenciale në vijë me teorinë mund të shërbejnë më pas për të propozuar buxhet më optimal në këtë aspekt. Konkretisht, mund të ndihmojnë në orientimin e ndihmës shtetërore tek kryefamiljarët që e përdorin atë në mënyrë më racionale.

## Dallimet gjinore në përfitimin e ndihmës sociale

### Skema e Ndhmës Sociale (SNS) në Kosovë

Përkujdesi ndaj familjeve dhe individëve në nevojë, në Kosovë rregullohet me Ligjin për skemën e ndihmës sociale<sup>12</sup>. Ky ligj rregullon mënyrën e mbështetjes së personave që rrezikohen nga varfëria si rrjedhojë e qasjes së tyre të dobët në tregun e punës, moshës së re, përkujdesjes ndaj ndonjë familjari apo paaftësisë për të punuar. Janë tri lloje pagesash që e përbëjnë Skemën e Ndhmës Sociale (SNS) dhe përmes të cilave synohet të arrihen objektivat më lartë: pagesa e ndihmës sociale, pagesa shtesë për fëmijët 0-18 vjeç dhe pagesa për ndihmë të veçantë.<sup>13</sup>

<sup>10</sup> Cituar në DeGraff, D. S., & Bilsborrow, R. E. (1993). Female-headed households and family welfare in rural Ecuador. *Journal of Population Economics*, 6(4), 317-336.


<sup>11</sup> Ikub. (2012). Gratë janë kryefamiljare më efikente se sa burrat. Burimi: <http://bit.ly/2ywLt7t>, qasur më 27 korrik 2017.

<sup>12</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 2003/15 për skemën e ndihmës sociale në Kosovë.

<sup>13</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Udhëzimi Administrativ Nr. 15/2012 për përlllogaritjen e shumës mujore të ndihmës sociale, Neni 5. Burimi: <http://bit.ly/2vVKxbW>.

Paga e ndihmës sociale sipas madhësisë së familjes paraqet kategorinë më të madhe të SNS-së. Për të fituar të drejtën e kësaj ndihme, familjet<sup>14</sup> duhet që, krahas kriterëve teknike<sup>15</sup>, të përmbushin disa kriterë jo-financiare dhe financiare. Kriteret jo-financiare përcaktojnë se përveç të qenurit banorë të përhershëm të Kosovës<sup>16</sup>, familjet duhet të jenë pjesë e njërës prej kategorive të definuara sipas ligjit në fjalë, kategorisë I apo II. Në kategorinë I, siç shpjegon Figura 1 më poshtë, të gjithë anëtarët e familjes duhet të jenë të varur dhe të papunësuar. Ndërsa, në kategorinë II hyjnë familjet që kanë një person të aftë për punë ose janë persona të varur dhe që pjesë e tyre është edhe ndonjë fëmijë nën moshën pesë vjeçare ose kujdestar i përhershëm i një fëmije jetim më i vogël se 15 vjeç.<sup>17</sup>

**FIGURA 1:** PASQYRIMI GRAFIK I KRITEREVE JO-FINANCIARE PËR NDIHMË SOCIALE



**Burimi:** Instituti GAP, bazuar në të dhënat e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale

<sup>14</sup> Një individ konsiderohet si familje një anëtarëshe.


<sup>15</sup> Që përfshijnë dorëzimin e dokumenteve sikurse letërnjoftimet e anëtarëve mbi 16 vjeç, vërtetimet e ndryshme shkollore dhe komunale etj. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Udhëzimi Administrativ Nr. 04/2013 për procedurat e paraqitjes së kërkesave për ndihmë sociale. Burimi: <http://bit.ly/2vNJD0H>.

<sup>16</sup> Përjashtim bëjnë personat me leje qëndrimi në Kosovë, azilkërkuesit, refugjatët dhe personat që gëzojnë mbrojtje të përkohshme dhe plotësuese. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 2003/15 për skemën e ndihmës sociale në Kosovë, neni 4. Burimi: <http://bit.ly/2vpJSwX>.

<sup>17</sup> Ibid. Neni 4

Krahas kritereve jo-financiare, ekzistojnë edhe ato financiare të cilat duhet të përmbushen nga familjet që paraqesin kërkesë për ndihmë sociale. Kriteret në fjalë specifikojnë se familjet duhet të posedojnë mjete nën pragun e lejuar dhe të hyrat e përgjithshme t'i kenë të njëjta apo nën vlerën e paraparë nga ligji në fjalë. Vlerësimi i mjeteve dhe të hyrave bëhet përmes testeve të verifikimit<sup>18</sup> ku në rast se pikët totale janë 140 ose më pak<sup>19</sup> familjes i ndahet ndihma sociale. Për pjesën e të hyrave, ato duhet të jenë të njëjta me shkallët standarde mujore të shprehura në formë të pikëve, të përcaktuara në ligj, të cilat ndryshojnë varësisht nga madhësia e familjeve. Këto pikë përcaktojnë edhe pagesën mujore që familja do të marr në rast se e njëjta i përmbush të gjitha kriteret. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Ministria e Financave obligohen që çdo vit të nxjerrin vendim në lidhje me përkthimin e një pike në vlerë monetare.<sup>20</sup> Në Figurën 2 specifikohen shumatat e ndihmës sociale sipas numrit të anëtarëve për vitin 2015.<sup>21</sup> Siç vërehet, pagesa e ndihmës sociale për anëtarë është në raport invers me numrin e anëtarëve të familjes. Deri në tre anëtarë pagesa për anëtar është rreth 25 euro, ndërsa për secilin anëtar shtesë ndahen rreth gjashtë euro më shumë. Pra, familjet me më shumë anëtarë marrin më pak ndihmë sociale për anëtar.

**FIGURA 2:** PAGESAT MUJORE TË NDIHMAVE SOCIALE



\*Për rastet kur familja ka mbi 15 anëtarë, ndihma sociale rritet për pesë euro për secilin anëtar shtesë.

**Burimi:** Instituti GAP, bazuar në të dhënat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës

<sup>18</sup> Testet janë të detajuara në Udhëzimin Administrativ Nr. 15/2012 për përllogaritjen e shumës mujore të ndihmës sociale. Burimi: <http://bit.ly/2vVKxbW>.

<sup>19</sup> Në raste të veçanta udhëheqësi/ja i/e SNS-së së bashku me ekipin e tij/saj mund të vendosin që ndihma sociale t'u jepet edhe familjeve që janë vlerësuar me maksimum 150 pikë. Burimi: <http://bit.ly/2wKyxHh>.

<sup>20</sup> Ligji Nr. 2003/15 për skemën e ndihmës sociale. Burimi: <http://bit.ly/2vp1hYr>.

<sup>21</sup> Statistikat e Mirëqenies Sociale (2016). Agjencia e Statistikave të Kosovës. Burimi: <http://bit.ly/2gmGdt5>



Përveç pagës së ndihmës sociale, familjeve të kualifikuara u ndahen edhe nga pesë euro shtesë në rast se kanë fëmijë që janë nga 0 deri 18 vjeç. Kjo pagesë bëhet për të ua mundësuar familjeve që të shpenzojnë për arsim dhe shëndetësi.<sup>22</sup> Po ashtu, siç shihet në Figurën 1, krahas pagës së ndihmës sociale, familjet të cilat janë pjesë e kësaj skeme përfitojnë edhe lehtësime tjera. Këto familje nuk paguajnë energji elektrike nëse shpenzojnë deri në 400 kWh gjatë muajit, dhe lirohen nga taksat komunale, shërbimet primare dhe sekondare shëndetësore, dhe më shumë.<sup>23</sup>

Por, përfituesit e ndihmës sociale nuk lirohen edhe nga pagesa e tatimit në pronë. Sipas ligjit në fuqi<sup>24</sup> dhe rregulloreve komunale, sikurse ajo e Komunës së Prishtinës<sup>25</sup>, lirohen nga tatimi vetëm një grup organizatash dhe institucionesh kryesisht publike dhe ndërkombëtare. Kështu që, marrë parasysh dallimet në vlerësimin e pronave dhe shkallët e tatimit të aplikuara nga komunat<sup>26</sup>, buxheti i familjeve pjesë e skemës së ndihmës sociale do të duhej të ishte i pabarabartë. Mirëpo, ligji dhe rregulloret në fjalë parashohin që të mos u konfiskohet ndihma sociale personave që nuk paguajnë shumën e plotë të tatimit në pronë.

Ndërkaq, pagesa tjetër e skemës, kategoria e ndihmës së veçantë, destinohet për rastet e jashtëzakonshme sikurse kur ndodhin vërshime, tërmete etj. Kjo ndihmë u ndahet të gjithë personave në nevojë pavarësisht nëse janë përfitues të ndonjëres prej pagave të skemës së ndihmës sociale apo jo.

### Shpërndarja gjinore e përfituesve të ndihmës sociale

Aktualisht në Kosovë janë mbi 26 mijë familje me rreth 108 mijë anëtarë që marrin ndihmë sociale si pjesë e SNS-së. Bazuar në buxhetin mujor të ndarë përgjatë vitit 2017, për familjet pjesë e SNS-së (rreth 2.4 milionë euro), një familje 4 anëtarëshe mesatarisht merr rreth 92 euro në muaj. Ndër komunat me numrin më të madh të familjeve që janë pjesë e SNS-së janë Mitrovica Jugore, Prishtina, Vushtrria, Lipjani dhe Drenasi (Figura 3).

<sup>22</sup> Udhëzimi Administrativ Nr. 15/2012 për përlllogaritjen e shumës mujore të ndihmës sociale, Neni 12. Burimi: <http://bit.ly/2vVKxbW>.


<sup>23</sup> Ibid. Neni 5

<sup>24</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 03/l-204 Për tatimin në pronën e paluajtshme.

<sup>25</sup> Komuna e Prishtinës, Rregullore për tatimin në pronën e paluajtshme. Burimi: <http://bit.ly/2uUbfvO>.

<sup>26</sup> Për shembull, në komunën e Pejës pronari i një banese 70m<sup>2</sup> në zonën e parë paguan tatim në pronë 47.25 euro, ndërsa pronari një banese me specifika të njejta në Prishtinë paguan 46.20 euro.

**FIGURA 3:** SNS SIPAS DISA KOMUNAVE



**Burimi:** Instituti GAP, bazuar në të dhënat e MPMS

Sa i përket shpërndarjes së ndihmave sociale sipas klasifikimit nëpër kategori, vërehet se bartëset më të mëdha të ndihmave sociale janë familjet me kushte të vështira ekonomike (kategoria I). Specifikisht, afro 65% e familjeve që morën ndihmë sociale në muajin maj të këtij viti ishin pjesë e kategorisë I, në të cilën bëjnë pjesë familjet ku të gjithë anëtarët janë të papunë dhe të varur (shih definicionin në Figurën 1).

Ndërkaq, në aspektin gjinor, vërehet një shpërndarje më e barabartë në kategorinë I, ku 45% e bartësve ishin gra dhe 55% burra. Një dallim më i madh në këtë aspekt vërehet në kategorinë II, ku vetëm 8% të bartësve ishin gra. Marr parasysh faktin që një pjesë e familjeve që klasifikohen në kategorinë II marrin ndihmë sociale pasi që kujdesen për ndonjë fëmijë nën moshën pesë vjeçare, ku kujdestare zakonisht janë nënat në këto raste, numri i bartëseve gra të ndihmës sociale del të jetë shumë i vogël.

**TABELA 1:** SHPËRNDARJA E NDIHMAVE SOCIALE SIPAS KATEGORIVE DHE GJINISË, MAJ 2017

Kategoria I-rë		Kategoria II-të		Kategoria I dhe II	
F	M	F	M	F	M
7,715	9,252	711	8,565	8,426	17,817
45%	55%	8%	92%	32%	68%

**Burimi:** Instituti GAP, bazuar në të dhënat e MPMS.

Nëse analizojmë shumën që përfiton një familje katër anëtarëshe sipas SNS-së, dallojmë se shumata e ndara nga kjo skemë janë të pa mjaftueshme që familjet t'i ikin kufirit të varfërisë së skajshme. Sipas vlerësimit të varfërisë në konsum në Kosovë, nga ASK në 2015, kufijtë e varfërisë dhe varfërisë së

skajshme janë 1.82 euro, përkatësisht 1.3 euro, në ditë për person.<sup>27</sup> Andaj, ndihma sociale arrin që të ia mbulojë një familje katër anëtarëshe që është pjesë e ndihmës sociale vetëm rreth 52% të shumës që do t'i duhej për t'i ikur pragut të varfërisë së skajshme.

### Dallimet gjinore në shpenzimin e buxhetit të familjes

Siç u theksua në pjesën më lartë, studimet tregojnë një tendencë të grave kryefamiljare për shpenzim më të madh të buxhetit në edukim dhe shëndetësi ndërsa të burrave kryefamiljarë në duhan, ushqim dhe pije. Duke u bazuar në studimin e Donkoh dhe Amikuzuno (2011), kemi konstruktuar modele të ngjashme për të analizuar këto hipoteza në mënyrë kuantitative për rastin e Kosovës.<sup>28</sup> Konkretisht, në këtë analizë kemi matur dallimet në mes të grave dhe burrave kryefamiljarë në shpenzimet në shëndetësi dhe duhan duke u mbështetur në modelin Logit (shih në Aneks formën e modelit Logit).<sup>29</sup>

Sa i përket shpenzimeve të kryefamiljarëve për shëndetësi, sipas këtij modeli del se në Kosovë të qenurit kryefamiljar burrë ul gjasat për të shpenzuar në shëndetësi për rreth 6%. Megjithatë, kryefamiljarët më të shtyrë në moshë kanë më shumë gjasë të shpenzojnë për shëndetësi. Kjo mund të ndodhë kryesisht për shkak se vetë kryefamiljari/ja në moshë më të shtyrë ka gjasë të përballët më shpesh më probleme shëndetësore apo ai/a jo kupton më mirë rëndësinë e kontrolleve mjekësore. Ngjashëm, Norton et al. (2006) gjejnë në studimin e tyre që personat e moshës 66 vjeç shpenzojnë rreth gjashtë herë më pak për shëndetësi se sa ata të moshës 95 vjeç.<sup>30</sup>

Po ashtu, në vijë më pritjet, rritja e një familjeje 5 anëtarëshe për një anëtar shtesë rritë gjasat për shpenzime në shëndetësi për afro 2%. Kurse, familjet që jetojnë në zona urbane shpenzojnë rreth 7% më pak në shëndetësi. Tendencë të njëjtë të dallimit në shpenzimin për shëndetësi në mes të zonës

<sup>27</sup> Varfëria në Konsum në Republikën e Kosovës në periudhën 2012 – 2015. Prill 2017. Agjencia e Statistikave të Kosovës. Burimi: <http://bit.ly/2I38Uk0>.

<sup>28</sup> Të dhënat e përdorua për analizimin e shpenzimit të buxhetit nga ekonomitë familjare burojnë nga Anketa e Buxhetit të Ekonomive Familjare (ABEF) 2016 e Agjencisë së Statistikave të Kosovës. Kjo mostër përbëhet prej 2,313 familjeve të cilat udhëhiqen nga gra dhe burra kryefamiljarë, ku pjesë e tyre janë edhe gratë dhe burrat kryefamiljarë pjesë e SNS-së. Burimi: <http://bit.ly/2xO6gDt>, faqe 29

<sup>29</sup> Për shkak të observimeve të pakta rreth shpenzimeve të grave kryefamiljare për edukim dhe alkool, nuk kemi mundur të masim dallimet mes dy grupeve edhe në këto aspekte.

<sup>30</sup> Norton, E. C., Wang, H., & Stearns, S. C. (2006). Out-of-pocket health care expenditures. *Swiss J Econ Stat*, 142, 3-11.

urbane dhe rurale gjejnë edhe Hotchkiss et al. (1998) në studimin e tyre për Nepal.<sup>31</sup>

Ndërsa sa i përket shpenzimit të kryefamiljarëve për duhan, të gjeturat tona tregojnë se të qenurit kryefamiljar burrë në Kosovë rrit gjasat për të shpenzuar në duhan për rreth 7%.<sup>32</sup> Në një studim të ngjashëm në Indi, Neufeld et al. (2005) gjejnë se burrat shpenzojnë për duhan shumëfish më shumë se sa gratë (rreth 25 herë).<sup>33</sup> Ndërsa, gjasat që kryefamiljarët më të shtyrë më moshë të shpenzojnë në duhan janë më të vogla edhe pse janë pozitive. Gjasat më të larta për përdorim të duhanit nga personat me të ri në moshë dhe ata më të shtyrë në moshë janë të ngjashme me gjetjet në vendet tjera ku të dy këto grupe kanë gjasë të shpenzojnë për duhan.<sup>34</sup>

Kurse, modeli i tretë është konstruktuar më shumë për të mbështetur qëndrueshmërinë e argumentit se burrat kryefamiljarë kanë më pak tendencë për të shpenzuar në kategori që promovojnë mirëqenien. Ky model, ku variabël e varur është shpenzimi për qumësht, djathë dhe vezë, po ashtu konfirmon se të qenurit kryefamiljarë burrë ul gjatë gjasat që buxheti familjar të drejtohet nga shpenzimi në ushqime cilësore. Po ashtu, rezultatet tregojnë se shpenzimi në ushqime më të shëndetshme ulet më rritjen e numrit të anëtarëve të një familje, kjo pasi rritja e familjes mund të përkojë me rritjen e shpenzimeve në kategoritë tjera. Ndërsa, posedimi i pronës dhe rritja marginale e të hyrave vjetore të ekonomisë familjare, sipas modelit tonë rrisin gjasat për shpenzim më të madh në produktet ushqimore të shëndetshme. Gjithsesi, në literaturë ka gjetje të ndryshme në këtë pikë, sidomos rreth ndryshimit të preferencave të njerëzve në konsum si rezultat i rritjes së të hyrave të tyre.

---

<sup>31</sup> Hotchkiss, D. R., Rous, J. J., Karmacharya, K., & Sangraula, P. (1998). Household health expenditures in Nepal: implications for health care financing reform. *Health policy and planning*, 13(4), 371-383.

<sup>32</sup> Një gjetje e tillë është evidente në shume shtete. Shih për më shumë Palipudi, K. M., Gupta, P. C., Sinha, D. N., Andes, L. J., Asma, S., McAfee, T., & GATS Collaborative Group. (2012). Social determinants of health and tobacco use in thirteen low and middle income countries: evidence from Global Adult Tobacco Survey. *PLoS one*, 7(3), e33466.

<sup>33</sup> Neufeld, K. J., Peters, D. H., Rani, M., Bonu, S., & Brooner, R. K. (2005). Regular use of alcohol and tobacco in India and its association with age, gender, and poverty. *Drug and alcohol dependence*, 77(3), 283-291.

<sup>34</sup> Ibid

## Përfundime dhe rekomandime

Në këtë analizë kemi pasqyruar në mënyrë kuantitative tendencat e kryefamiljarëve në Kosovë rreth shpenzimit për shëndetësi dhe duhan më qëllim që të mund të jepem rekomandime rreth buxhetimit gjinor në pjesën e Skemës së Ndhmës Sociale. Gjetjet tona tregojnë që kryefamiljarët burra në Kosovë shpenzojnë më pak në shëndetësi dhe më shumë në duhan. Këto modele që kemi zhvilluar mund të shërbejnë si bazë në hulumtimin e mëtejshëm në këtë aspekt, marrë parasysh në të ardhmen që mund të trajtohen edhe çështje më të hollësishme, sikurse analizimi i elasticitetit të shpenzimit në këto kategori nga kryefamiljarët varësisht nga ndryshimet në të ardhurat e tyre, ndërtimi i një mostre reprezentative që përbëhet vetëm nga bartësit e ndihmave sociale, etj.

Marrë parasysh gjetjet më lartë, ku dallohet se gratë kryefamiljare menaxhojnë më mirë më buxhetin e ekonomisë familjare se sa burrat kryefamiljarë, qeveria duhet të rrisë numrin e bartëseve gra të ndihmës sociale kur një gjë e tillë është e mundur. Një hap i tillë do të rezultonte në një politikë më optimale dhe rritje të mirëqenies.

Po ashtu, duke pasur parasysh se një pjesë e familjeve që klasifikohen në kategorinë II sipas SNS-së marrin ndihmë sociale pasi që kujdesën për ndonjë fëmijë nën moshën pesë vjeçare apo fëmijë jetim nën moshën 15 vjeç, ku kujdestare më me shumë gjasë janë nënat, është e domosdoshme të rritet numri i bartëseve gra të ndihmës sociale në këtë kategori.

Kjo mund të bëhet duke ndryshuar Ligjin për skemat e ndihmës sociale ku parashihen shuma më të larta të ndihmës sociale për rastet kur për ndihmë aplikojnë gratë. Një hap i tillë do të shërbente si incentivë për ekonomitë familjare që bartëse të ndihmës të jenë gratë pasi që një vendim i tillë do të rezultonte me të hyra mujore më të larta për ta.

## Aneks

Modeli Logit bën pjesë në grupin e modeleve probabilistike që ka variabël të varur binare, që merr vlerat 1 ose 0. Si i tillë, modeli përlllogarit gjasat që një individ të jap përgjigjen që klasifikohet nën 1 dhe jo nën 0. Forma e modelit Logit është si në vijim:

$$\Pr(y=1 | \mathbf{x}) = F(\beta_0 + \beta_1 x_1 + \dots + \beta_k x_k) = F(\mathbf{x}\boldsymbol{\beta})$$

ku Pr tregon probabilitetin për të shpenzuar në shëndetësi,  $y$  variablën e varur,  $\boldsymbol{\beta}$  vektorin e koeficientëve dhe  $\mathbf{x}$  vektorin e variablave të pavarura. Ndërsa,  $F$  është funksioni logjistik që merr vlera vërtetë mes 0 dhe 1. Kurse,

$$F(\mathbf{x}\boldsymbol{\beta}) = \frac{e^{\mathbf{x}\boldsymbol{\beta}}}{1 + e^{\mathbf{x}\boldsymbol{\beta}}} = \Lambda(\mathbf{x}\boldsymbol{\beta})$$

ku  $\Lambda(\cdot)$  është funksioni kumulativ i shpërndarjes për të gjithë numrat real.<sup>35</sup> Në rastin tonë, modeli rreth shpenzimit në shëndetësi do të dukej kështu:

$$\begin{aligned} \text{logit}(\Pr_{\text{Shëndetësia}}) = \ln\left(\frac{Pr}{1-Pr}\right) = & \beta_0 + \beta_1 \text{kryefamiljar} + \beta_2 \text{madhësia\_hh} + \\ & \beta_3 \text{mosha} + \beta_4 \text{urban\_rural} + \beta_5 \text{mosha}^2 + \\ & \beta_6 \text{pronësia} + \beta_7 \text{ardhurat} + \beta_7 \text{kredi} \end{aligned}$$

i cili model paraqet logaritmin e normave të mundësisë (odds ratios) për secilën variabël. Transformimi i modelit përmes aplikimit të logaritmit jep një funksion linear të variablave të pavarura  $\mathbf{x}$ . Por, pasi që rezultatet e modelit më lartë (odds ratios) nuk mund të interpretohen direkt, më poshtë janë prezentuar kalkulimet e efekteve marginale në mesataret e variablave të pavarura duke kontrolluar për efektet e variablave tjera të pavarura (*ceteris paribus*). Ky rregull vlen edhe gjatë shpjegimit të rezultateve të modeleve.

---

<sup>35</sup> Wooldridge, J. M. (2015). *Introductory econometrics: A modern approach*. Nelson Education.

**TABELA 2:** VARIABLAT E PËRDORURA NË MODELE

Variabla e varur
Shpenzimi për shëndetësi (modeli 1); duhan (modeli 2); ushqime të shëndetshme (modeli 3) - (1 nëse shuma e shpenzuar gjatë vitit është më e madhe se 0, përndryshe 0)
Variablat e pavarura
<i>kryefamiljar</i> (1 = burrë, 0=grua)
<i>madhësia_hh</i> (numri i anëtarëve të familjes)
<i>mosha</i> (në vite)
<i>urban_rural</i> (1= zonë urbane, 0= zonë rurale)
<i>mosha<sup>2</sup></i> (mosha në vite në katrorë) Kjo variabël është përfshirë për të konsideruar tendencat ndryshe të kryefamiljarëve në moshë të shtyrë, sidomos në modelet 1 dhe 3.
<i>pronësia</i> (1= nëse kryefamiljari/ja zotëron pronë të saj, përndryshe 0)
<i>ardhurat</i> (të ardhurat e ekonomisë familjare gjatë një viti, si shumë)
<i>kredi</i> (1= nëse kryefamiljari/ja ka aktualisht kredi, përndryshe 0)

**TABELA 3:** DEFINICIONI I VARIABLAVE TË VARURA TË PËRDORURA NË MODELE

Definicioni i variablave të varura
<b>Shpenzimi për shëndetësi</b> – shpenzimi në barëra, preparate terapeutike, shërbime mjekësore brenda dhe jashtë spitalit, shërbime stomatologjike, analiza mjekësore, barërat tradicionale etj.
<b>Shpenzimi për duhan</b> – shpenzimi në cigare në pako, cigare apo duhan tjetër
<b>Shpenzimi për ushqime të shëndetshme</b> – shpenzimi në qumësht më pak yndyrë, qumësht i freskët, tetrapak, djath i freskët, vezë etj.

**Burimi:** Instituti GAP, bazuar në të dhënat e Anketës së Buxhetit të Ekonomive Familjare

**TABELA 4:** GJETJET E MODELEVE (LOGIT)

	Shëndetësi dy/dx	Duhan dy/dx	Ushqim dy/dx
<i>kryefamiljar</i>	-0.060*	0.070**	-0.044***
<i>madhësia_hh</i>	0.021***	0.025***	-0.005***
<i>mosha</i>	-0.012*	0.020***	0.0001
<i>urban/rural</i>	-0.070***	0.014	0.170***
<i>mosha<sup>2</sup></i>	0.0002***	0.0002***	0.000
<i>pronësia</i>	-0.050	0.016	0.170***
<i>ardhurat</i>	0.000***	0.000	0.000**
<i>kredi</i>	0.044	-0.030	-0.079

Signifikanca: \* 10%; \*\* 5%; \*\*\* 1%

INSTITUTI GAP  
GAP INSTITUTE



Instituti GAP është think-tank i themeluar në tetor të 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtisë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtisë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.

**Instituti GAP mbështetet nga:**



Rockefeller  
Brothers Fund  
Philanthropy for an Interdependent World

